



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 480/ 14 prot.

Datë 07/05/2024

V E N D I M

Nr. 457/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07/05/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Librari Dyrrahu*” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra*”, me Nr. REF-92436-12-28-2023, me objekt: “*Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme*”, me fond limit 7.999.967,23 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SH.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Librari Dyrrahu*” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra*”, me Nr. REF-92436-12-28-2023, me objekt: “*Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme*”, me fond limit 7.999.967,23 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SH.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*INTERLOGISTIC*” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra*”, me Nr. REF-92436-12-28-2023, me objekt: “*Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme*”, me fond limit 7.999.967,23 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “*INTERLOGISTIC*” ShPKme NIPT: K21605003M dhe me adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës km 09, Kashar, Tiranë.*

Operatori ekonomik “*InfoSoft Office*” ShPKme NIPT: J62426002Q dhe me adresë: *Autostrada Tiranë – Durrës, km 8, Kodër Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SH.A
Adresa: L.17 Rruga “Dalip Peza”, Durrës.

Persona të interesuar: Operatori ekonomik “*Librari Dyrrahu*” ShPKme NIPT: L91418502J dhe me adresë: *Zona Kadestrale nr.8517, e llojit trull plus ndërtesë 4 kate, me sipërfaqe trualli 1’000 m2 dhe sipërfaqe ndërtesë 330 m2, Spitallë, Durrës.*

Operatori ekonomik “*INTERLOGISTIC*” ShPKme NIPT: K21605003M dhe me adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës km 09, Kashar, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë interes për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të,

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.12.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra”, me Nr. REF-92436-12-28-2023, me objekt: “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme”, me fond limit 7.999.967,23 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A.

II.2. Në datë 07.02.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 19.02.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Librari Dyrrahu” ShPK	4,067,900.00 leke	kualifikuar
2. “Interlogistic” ShPK	5,512,477.00 leke	kualifikuar
3. “InfoSoft Office” ShPK	5,999,977.59 leke	kualifikuar
4. “IT GJERGJI KOMPJUTER” ShPK	6,869,447.00 leke	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 21.02.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “Librari Dyrrahu” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datë 27.02.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/3835, datë 27.02.2024, dhe me nr. 467/2024 prot, datë 27.02.2024 e operatorit ekonomik “INTERLOGISTIC” ShPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 467/2, datë 28.02.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*INTERLOGISTIC*” ShPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “*Librari Dyrrahu*” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 28/29 prot, datë 04.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 467/3 prot datë 06.03.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*INTERLOGISTIC*” ShPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.8. Me shkresën nr. 467/4 prot., datë 09.04.2024 me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “INTERLOGISTIC” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë mostrat e dorëzuara nga ana e ofertuesi “*LIBRARI DYRRAHU*” ShPK për artikujt objekt-prokurimi me numër rendor nr. 1 dhe nr 28 të përcaktuara në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të dokumentave të tenderit të modifikuar, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “*LIBRARI DYRRAHU*” ShPK për të justifikuar ofertën e tij ekonomike, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët.

II.9. Me shkresën nr. 28/31 prot, datë 12.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 467/5 prot datë 15.04.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, mostrat e dorëzuara nga ana e ofertuesi “*LIBRARI DYRRAHU*” ShPK për artikujt objekt-prokurimi me numër rendor nr. 1 dhe nr 28 të përcaktuara në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të dokumentave të tenderit të modifikuar, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre.

II.10. 27.02.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/3838, datë 27.02.2024, dhe me nr. 480/2024 prot, datë 27.02.2024 e operatorit ekonomik “*InfoSoft Office*” ShPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga në “*LIBRARI DYRRAHU*” ShPK dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*INTERLOGISTIC*” ShPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 480/2, datë 28.02.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK dhe mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “INTERLOGISTIC” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.12. Në datën 01.03.2024, operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK ka paraqitur argumentet e tij pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues “INTERLOGISTIC” SHPK dhe “InfoSoft Office” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.13. Në datën 01.03.2024, operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” ShPK ka paraqitur argumentet e tij pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.14. Me shkresën nr. 28/27 prot, datë 04.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 480/5 prot datë 06.03.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.15. Në datën 18.03.2024, operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës me nr. 28/27 prot, datë 04.03.2024 protokolluar me tonën me nr. 480/5 prot datë 06.03.2024 ka paraqitur informacion shtesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke sqaruar se:

“Me vendimin nr. 28/27, prot., datë 04.03.2024, KSHA në autoritetin kontraktor ka vendosur:

”1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "InfoSoft Office" shpk. për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje materiale kancelarie dhe të ngjashme ...”

SË PARI:

Në vendimin e mësipërm KSHA në autoritetin kontraktor arsyeton si më poshtë:

“...Nga verifikimi i bërë në SPE, dhe Pv-Vlerësimin të KVO-së, vërehet se OE Ekonomik ofertues Librari Dyrrahu ShPK referuar- DST-së dhe Shtojcës me ndryshimet përkatëse, ka rigarkuar në sistemin SPE katalog për produktin letër A4 80g/m2 të kompanisë PCL me markë tregtare DOUBLE-A, ku distributor i autorizuar për Shqipërinë është Europrinty Group ShPK bazuar në certifikatën e shpërndarjes me nr DA-COD-23-002, datë 01.01.2023 me afat deri në 31.12.2024. Në specifikimet teknike vërehet se gramatura nominale është 80 g/m2.

Më datë 01.02.2024 midis Europrinty Group ShPK si distributor i autorizuar për Shitjen e produktit letër DOUBLE-A dhe Librari Dyrrahu ShPK është nënshkruar një Marrëveshje

Bashkëpunimi ku EUROPRINTY GROUP ShPK merr përsipër furnizimin e subjektit Librari Dyrrahu ShPK, me të gjithë sasinë e artikullit letër A4, sipas specifikimeve të përcaktuara në procedurën e prokurimit. Në lidhje me kushtin që letra duhet të plotësojë standartet ISO 9706 ose ekuivalente, standart që plotëson kushtet për letrat që mbahen për një kohë shumë të gjatë në arkiva, GSHA pas një verifikimi në fq zyrtare të kompanisë double a (1991) public company limited thailand në Eëbsite: <https://www.doublepaper.com>, në katalogun e ngarkuar në Fq zyrtare të kompanisë faqe 3 shprehet se Letra Double -A4 80g/m2 i përmbahet standartit 9706, që don të thotë se është e përshtatshme për arkivë.

Nga sa më sipër ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE ankimes nuk merret në konsideratë..”

Sa më sipër arsyeton vetë KSHA, pranohet fakti se, në katalogët e dorëzuar nga ofertuesit “LIBRARI DYRRAHU” ShPK dhe “INTERLOGISTIC” ShPK, si pjesë të ofertës në SPE, nuk pasqyrohen të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në lidhje me artikullin Nr .1 Letër A4 80g/m2, e konkretisht në këtë katalog nuk është pasqyruar specifikimi teknik që letra e ofertuar të plotësojë standartet ISO 9706 ose ekuivalente standart që plotëson kushtet për letrat që mbahen për një kohë shumë të gjatë në arkiva. Këtë specifikim teknik këta ofertues nuk rezultojnë ta kenë vërtetuar me asnjë lloj dokumenti të hedhur në SPE si pjesë të ofertës së tij.

Edhe nëse marrim si në përputhje me rregullat e prokurimit publik, procedurën e ndjekur nga KSHA, e cila ka marrë përsipër të bëjë verifikime në faqen web të prodhuesit të letrës dhe më pas ka konstatuar se, në katalogun e ngarkuar në Fq zyrtare të kompanisë faqe3 shprehet se Letra Double -A4 80g/m2 i përmbahet standartit 9706, një fakt i tillë pas verifikimit të bërë nga shoqëria jonë po në këtë faqe web, nuk na rezulton që në këtë faqe të jetë informacioni se Letra A4 80g/m2 është e certifikuar dhe plotëson standartet ISO 9706.

KPP-ja në vendimet e saj shpesh ka theksuar faktin se, zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Ka qënë në detyrimin e ofertuesve “LIBRARI DYRRAHU” ShPK dhe “INTERLOGISTIC” ShPK që në katalogët e dorëzuar apo edhe me çdo dokument tjetër të vërtetonin se produkti letër A4 me të cilin kanë ofertuar të plotëson të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcën 5 të DT-së.

Vlerësimi i bërë nga KSHA —ja nuk është në përputhje me DT-të dhe rregullat e prokurimit publik dhe si i tillë duhet të ndryshohet.

SË DYTI:

Në lidhje me pretendimet tona në lidhje me mostrat e dorëzuara nga ofertuesit e konkretisht për ofertuesin “LIBRARI DYRRAHU” ShPK për mostrat per artlkujt, 5,7,9,11 dhe 28 dhe per ofertueisn “INTERLOGISTIC” ShPK, mostrat per artikuajt, 5,7,9 dhe 11, për të cilat ne besojmë se nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST, KSHA ka konstatuar se ato janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DT, pasi u bëri një rishikim visual këtyre mostrave, pra pa bërë asnjë lloj matje sipas rastit apo verifikime të detajuara për të vërtetuar plotësimin ose jo të të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara.

Në i qëndrojmë argumentave që kemi dhënë në ankesën tonë në lidhje me mostrat e dorëzuara të cilat nuk i përmbushin kërkesat e AK-së të përcaktuara në shtojcën 5 të dokumentave të tenderit.

SË TRETË:

Në lidhje me pikën e tretë të ankesës së shoqërisë tonë, për ofertuesin "Librari Dyrrahu" SHPK, ku kemi pretenduar se, ky ofertues nuk ka arritur të plotësojë konform rregullave shtojcën nr. 8 (Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit) të DST-ve, konkretisht pikën 6 të "Deklaratë për dorëzimin e ofertave të pavarura", pasi OE "Librari Dyrrahu" SHPK në këtë procedurë prokurimi është mbështetur në kapacitetin e një tjetër OE dhe alternativa e përziejdhur nga Ofertuesi duhet të jetë alternative e përcaktuar në pikën 6/b dhe jo alternativa 6/a.

Në lidhje me këtë pikë, KSHA ka arsyetuar:

"...Pas verifikimit të bërë në SPE vërehet se OE Librari Dyrrahu ShPK ka ngarkuar në sistem formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST-ve. OE ka qarkuar alternativën 6/a pasi oferta e tij është paraqitur si ofertë e pavarur. Pretendimi (interpretimi) i ngritur nga ankuesi në lidhje me këtë pikë nuk qëndron pasi alternativa 6/b shprehet qartësisht "... Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi", Nga verifikimi i bërë në SPE rezulton se subjekti Europrinty Group ShPK nuk ka shprehur interes për pjeëmarrje në këtë procedurë prokurimi. Vetëm në rast se do të shprehte interes për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi atëherë OE Librari Dyrrahu duhet të qarkonte alternativën nr 6/b, pasi subjekti Europrinty Group do të përcaktohej si konkurent në këtë procedurë. Shprehja Konkurent nga ana gjuhësore nënkupton "Ai që matet e konkurron me dikë për t'ia kaluar me çdo mënyrë a për të dalë i pari.",.

Nga sa më sipër ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE ankimues nuk merret në konsideratë ..."

Arsyetimi i mësipërm i grupit të shqyrtimit të ankesës nuk qëndron dhe nuk është në përputhje me rregullat e prokurimit public.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të Dt-së dhe konkretisht, pikën 6 të aneksit **B**: DEKLARATA (Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura) përcaktohet:

6. Ofertuesi deklaron se. (kliko një nga alternativat e mëposhtme).
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër,
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentel bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit)...

Pra alternativa 6/b) është alternativa që duhet të plotësohet nga ofertuesi "LIBRARI DYRRAHU" SHPK, për sa kohë ofertuesi ka bashkëpunuar me një tjetër operator ekonomik, në rastin konkret në formën e mbështetjes në kapacitetet e një subjekti tjetër.

Arsyetimi i KSHA —së se, "...subjekti Europrinty Group ShPK nuk ka shprehta interes për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi. Vetëm në rast Se do të shprehte interes për

pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi i atëherë OE Librari Dyrrahu duhet të qarkonte alternativën nr- 6/b, pasi subjekti Europrinty Group do të përcaktohej si konkurent në këtë procedurë..” nuk qëndron pasi edhe në rastin e pjesmarrjes së OE si bashkim operatorësh ekonomikë apo edhe si nënkontraktorë sërish as nënkontraktori dhe as pjestari në bashkimin e operatorëve ekonomikë nuk janë konkurentë të ndryshëm pasi ofertojnë vetëm më një ofertë por sërish rregullat e prokurimit publik parashikojnë që ata duhe të zgjedhin alternativën 6/b) në rast se marrim pjesë si nënkontraktorë apo si BOE. E njëjta logjikë dhe situatë është edhe në rastin e operatorit ekonomik i cili inbështet një tjetër operator ekonomik i cili dorëzon ofertë në një procedurë prokurimi.

Për sa kohë ofertuesi ka bashkëpunuar me një tjetër operator ekonomik, në rastin konkret në formën e mbështetjes në kapacitetet e një subjekti tjetër, deklarimi i tij se “...Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër” përbën një deklaram të rremë, që nuk i përgjigjet rrethanave të faktit pasi është e dukshme që ofertuesi nuk e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pasi ai është konsultuar, ka komunikuar dhe ka bërë marrëveshje dhe ka rënë dakord me operatorin ekonomik tek kapacitetet e të cilit është mbështetur për të paraqitur ofertën e tij në këtë procedurë prokurimi.

Në lidhje me operatorin mbështetës shoqëria jonë ka pasur edhe pretendim të tjera të cilat nuk janë marrë në shqyrtim nga KSHA, si:

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-së, nuk është plotësuar i saktë as nga subjekti mbështetës, pasi nuk janë plotësuar saktë në këtë formular të dhënat/gjeneralitetet e kësaj shoqërie, pra të shoqërisë në kapacitetet e të cilave është mbështetur ofertuesi.

Jo vetëm dorëzimi i formularit të veçantë të deklarimit sipas shtojcës 8 të DT-së edhe detyrim ligjor për subjektin mbështetës, kërkesë kjo e cila është përcaktuar qartësisht në vetë formularin standart të shtojcës 8 të DT-së ku shprehimisht thuhet: “...Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës...”, por ky formular, pra formulari i vetëdeklarimit duhet të plotësohet saktë nga subjekti mbështetës.

*E njëjta kërkesë është e **përcaktuar** edhe në shtojcën 7 (FORMULARI I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT) të DT-së ku përcaktohet se: “...Në rast se operatorit ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës...”*

Për sa më sipër i kërkojmë KPP-së shqyrtimin e plotë të të gjitha pretendimeve tona të parashtruara në ankesën tonë dhe në përfundim të vendoset pranimi i saj.

Në lidhje me pretendimin tonë se, OE Librari Dyrrahu nuk ka argumentuar çmimet e ofertës së tij në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-se, çmimin anomalisht të ulët të ofruar në këtë procedurë.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës në vendimin e tij ka arsyetuar dhe vendosur:

“...KVO me shkresën nr 28/15 prot, datëw 08.02.2024 i është drejtuar OE Librari Dyrrahti ku i ka kaerkuar “Paraqitjen e dokumentacionit mbi ofertën anomalisht të ulët”. Më datë

09.02.2024 OE Librari Dyrrahu SHPK, ka paraqitur shkresën me “Sqarim mbi Ofertën Anomalisht të ulët”. Në këtë shkresë Oe ka paraqitur një analizë të detajuar të kostos me përlllogaritje për çdo artikull, mbështetur në falura blerje artikujsh, fletë zhdoganimi, si dhe oferta të marra nga furnitorë të ndryshëm për këtë procedurë prokurimi.

Nga sa më sipër ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE ankimues nuk merret në konsideratë...”

Arsyetimi i mësipërm i KSHA-së është shumë sipërfaqësor dhe pavarësisht se deklarohet se: Oe ka paraqitur një analizë të detajuar të kostos me përlllogaritje për çdo artikull, mbështetur në falura blerje artikujsh, fletë zhdoganimi, si dhe oferta të marra nga furnitorë të ndryshëm për këtë procedurë prokurimi, por sërish ne besojmë se, nisur nga çmimet tepër të ulëta të paraqitura nga ky ofertues, ai nuk ka arritur të argumentojë konform kërkesave të nenit 93 të LPP-së çmimet anomalisht të ulëta.

Konkretisht dokumentacion provues në lidhje me çmimet me të cilat siguron 65 llojet e artikujve të kancelarisë të deklaruar në ofertë dhe të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike dhe ato të termave të referencës, pra faturat e blerjes për artikujt e kancelarisë, (nese i disponon) ose /dhe marrëveshjet apo ofertat e prodhuesit apo distributorët e deklaruar për sigurimin e këtyre pajisjeve, konkretisht me çmimet me të cilat ka deklaruar në analizën e kostos (nëse ka deklaruar të tilla) dhe jo fatura për artikuj të ngjashëm por fatura apo dokumentacion provues për sigurimin e artikujve objekt prokurimi, në të cilat duhet të jenë shprehur shumë qartë specifikimet teknike kërkuar në shtojcën 5 të DST-të, pasi janë pikërisht ato specifikime që bëjnë ndryshime të theksuar në çmime.

Gjithashtu, nga vetë mënyra si është shprehur KSHA, rezulton se dokumentacioni provues, është dërguar në mënyrë shkresore dhe jo nëpërmjet SPE, tek rubrika “kërkesa nga AK”, në përgjigje të kërkesës së AK. Nisur nga fakti se procedura është elektronike dhe jo shkresore, çdo dokumentacion që ka lidhje me vlerësimin e ofertave, ku përfshihet edhe argumentimi i çmimeve anomalisht të ulëta, duhet të hidhet edhe elektronikisht në sistem, duke zbatuar kështu një nga parimet bazë, atë të transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Të nderuar,

Sa më sipër kërkojmë shqyrtimin dhe pranimin e të gjitha pretendimeve tona të parashtruara në ankesën elektronike me numër aplikimi të ankesës online: A/2024/3838 | Numri i protokollit: 480/2024 | Data e protokollit: 2024-02-27.

Shpresojmë dhe besojmë në një vendimarrje të drejtë dhe në përputhje me ligjin nga ana juaj.”.

II.16. Me shkresën nr. 480/7 prot., datë 25.04.2024 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “INOSOFT OFFICE” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti kontraktor të dorëzojë pranë institucionit tonë mostrat e dorëzuara nga ana e ofertuesi “LIBRARI DYRRAHU” ShPK për artikujt objekt-prokurimi me numër rendor nr.5, nr.7, nr.9 dhe nr.11, të përcaktuara në Shtojcën 6 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuar, si dhe mostrat e dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “INTERLOGISTIC” ShPK për artikujt objekt-prokurimi me numër rendor nr. 1, nr. 5, nr. 7, nr. 9 dhe nr. 11, të përcaktuara në Shtojcën 6 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” të dokumentave të tenderit të

modifikuara, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre.

II.17. Me shkresën nr. 480/8 prot., datë 25.04.2024 me objekt *“Kërkesë për informacion”*, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga operatorit ekonomik *“INTERLOGISTIC”* ShPK të dorëzojë pranë institucionit tonë informacionin dhe faktet se cili/at nga specifikimet teknike të mësipërme të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 *“FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”* të dokumentave të tenderit të modifikuara janë pasqyruar në skedën teknike të produktit të ofruar nga ana juaj të markës *“Double A 80”* dhe i paraqitur nga ana e tij në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), duke identifikuar secilin prej specifikimeve teknike të kësaj shtojce në skedën teknike të dorëzuar.

II.18. Me shkresën e datës 30.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 480/9 prot, datë 02.05.2024, është depozituar nga e operatorit ekonomik *“INTERLOGISTIC”* ShPK përgjigja lidhur me shkresën nr. 480/8 prot., datë 25.04.2024 me objekt *“Kërkesë për informacion”*, ku janë identifikuar në skedën teknike të dorëzuar nga ky ofertues specifikimet teknike të produktit objekt-prokurimi *“Leter A4 e bardhe 80gr/m2”* të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 *“FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”* të dokumentave të tenderit të modifikuara, si dhe për specifikimet teknike më numër rendor 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 *“FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”* të dokumentave të tenderit të modifikuara është shprehur si në vijim: *“Gjithashtu ju bëjmë me dije se në lidhje me parametrat e kërkuar nga pika 10 deri tek pika 16 janë parametra të p-ërgjithshme të cilët nuk përfshihen në skedën teknike.”*.

II.19. Me shkresën nr. 28/34 prot, datë 02.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 480/10 prot datë 03.05.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, mostrat e dorëzuara nga ana e ofertuesi *“LIBRARI DYRRAHU”* ShPK për artikujt objekt-prokurimi me numër rendor nr.5, nr.7, nr.9 dhe nr.11, të përcaktuara në Shtojcën 6 *“FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT”* të dokumentave të tenderit të modifikuara, si dhe mostrat e dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik *“INTERLOGISTIC”* SHPKpër artikujt objekt-prokurimi me numër rendor nr. 1, nr. 5, nr. 7, nr. 9 dhe nr. 11, të përcaktuara në Shtojcën 6 *“FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT”* të dokumentave të tenderit të modifikuara, si dhe procesverbali imbaytur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre.

II.20. Në shkresën e datës 03.05.2024 të operatori ekonomik *“InfoSoft Office”* ShPK dhe të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 480/11 prot, datë 07.05.2024, ka kërkuar si në vijim: *“... Për sa më sipër, për një shqyrtim sa më të plotë të të gjitha pretendimeve tona të parashtruara në ankesë dhe në përputhje të plotë me ligin e prokurimit publik dhe Kodin e Procedurave Administrative, Ju kërkojmë: Institucioni Juaj, t'i kërkojë autoritetit kontraktor, SHOQËRISË RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME DURRESES SHA, te dorezoje prane KPP-se, edhe mostrat produkteve te dorezuara nga ofertuesi "LIBRARI DYRRAHU" SHPK, me numrat rendore: Nr.1 (Leter A4 e bardhe 80g/m2) dhe Nr.28 (Flash driver 64 GB me skanim te Shenies se gishtit (min 6 shenja). Garanci "Lifetime"), pr këte procedure prokurimi. jithashtu, ne shkresen me 28/34 prot., date 02.05.2024, ne pergjigje te kerkeses nr. 480/7 prot., date 25.04.2024 te KPP-s, autoriteti*

kontaktor, SHOQËRIA RAJONALE UËSJELLES KANALIZIME DURRES" SHA, nuk rezulton gjithashtu se, autoriteti kontraktor ka dorezuar ne KPP, dokumentacionn e paraqitur nga shogeria "LIBRARI DYRRAHU" SHPKpër të justifikuar ofertën e tij ekonomike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik "Infosoft Office" ShPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", në të cilin parashikohet se "1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre", nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik "Infosoft Office" ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e e ofertës së shoqërisë "INTERLOGISTIC" ShPK, nga verifikimi i dokumentave të tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, këto kritere kualifikuese dhe specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkaktojnë konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tyre, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht vëren se:

III.1.2. Në kriterin kualifikues të pikës 2.4.1 dhe pikës 2.4.3 "Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim" të shtojcës 7 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT" të dokumentave të tenderit të modifikuara, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

2.4.1. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et e prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi per produktin:

- (Nr:1) Leter A4 80g/m2,

2.4.3 Operatoret ekonomike pjesemarres ne kete procedure duhet qe ditën dhe oren e hapjes se ofertave, te paraqesin mostra per artikujt me nr rendor: Rendor 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 16, 21, 22, 24, 26, 28, 51. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

III.1.3. Në shtojcën 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*”, të dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka publikuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Lista e materialeve:

NR	Mostra	PERSHKRIMI	Njesia	Sasia
1	PO	Leter A4 e bardhe 80gr/m2	rizma/500fl	2,000
2		Leter A3 e bardhe 80gr/m2	rizma/500fl	50
3	PO	Zarfa plasmasi me vrima A4 100 micron. Pako me 100 cope.	Pako	1,800
4		Dosje me kuti me mekanizem 5cm	cope	200
5	PO	Dosje A4 plastike, me llastik dhe klip (kapese)	cope	500
6		Dosje me buton 7-9 cm kartoni	cope	50
7	PO	Dosje me unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza. Ne brendesi dosja te permbaje xhep per leter A4 dhe bllok A4, mbajtjese stilolapsi dhe minimumi 3 xhepa te vegjel .	cope	400
8		Dosje plastike me min 80 qese brenda me kuti	cope	50
9	PO	Dosje me buton, plastike ose ekuivalent rezistente ndaj lageshtires, me gjeresi min 20 cm, me doreze dhe me xhep per etikete shenimesh .	cope	1,000
10		Stilolapsa cilesor ngjyre blu 0.7mm	cope	100

11	PO	Rapidograf, me majë të hollë 0.3-0.4mm, ngjyre blu. Të mos zbehet dhe të mos lëshojë njolla.	cope	5,000
12		Lapsa plumbi	cope	200
13	PO	Marker I zi permanent	cope	1,000
14		Marker komplet me 4 ngjyra te ndryshme per table shenimesh	Kuti/4cp	200
15		Ndarese plastike 45x12mm (±2%), me min 5 ngjyra te ndryshme nga minimumi 25 flete.	cope	300
16	PO	Leter shenimesh me ngjitje permasa min 76mm x 76mm (±2%), me min 7 ngjyra te ndryshme, minimumi 280 fl.	cope	500
17		Korrektor stilo	cope	200
18		Makine Llogaritese Profesionale me permasa minimumi 205mm x 160mm x 40mm ,me cels per ndezje.	cope	30
19		Gershere te mesme minimumi 16.5cm	cope	50
20		Heqese telash stapleri	cope	40
21	PO	Makine kapese per dokumenta 23/23	cope	150
22	PO	Tela makine 23/23	cope	500
23		Vinovil 100gr shishe	cope	50
24	PO	Zarfa A4 me flluska ajri brenda	cope	7,000
25		Kapak plastik per CD-DVD	cope	500
26	PO	Toner per Printer HP Pro LaserJet MFP M225dë, 2200 kopje. PN CF283X/ CF283XC.	cope	150
27		Leter Rrula kase fiskale (dimension i gjere 11 cm)	pako/10 cp	300
28	PO	Flash driver 64 GB me skanim te shenjës se gishtit (min 6 shenja) . Garanci "Lifetime"	cope	100
29		Flash driver 128 GB me skanim te shenjës se gishtit (min 6 shenja).Garanci "Lifetime"	cope	100
30		Bateri per telekomande AA 1.5v LR6 (e madhe)	cope	200
31		Bateri per telekomande AAA 1 .5v LR03 (e vogel)	cope	200
32		Skoc letrë (gjerësi 50mm-52mm dhe gjatësi minimumi 50 m)	cope	50
33		CD-RË 4X-12X, 700MB, pako me 50cp	pako	20
34		Vizore Plastike 30 cm	cope	50
35		Kapese aktësh me veshe 32 mm 12 cope/pako	pako	150
36		Kapese aktësh me veshe 51 mm 12 cope/pako	pako	50
37		Kapese aktësh me veshe 67 mm 12 cope/pako	Pako/12cp	50

38		<i>Maus Optical USB</i>	<i>cope</i>	30
39		<i>Tastier USB</i>	<i>cope</i>	30
40		<i>Blloqe Flete Dalje</i>	<i>cope</i>	300
41		<i>Blloqe Flete Hyrje</i>	<i>cope</i>	150
42		<i>Liber Magazine min 200 faqe 24 cm*17 cm</i>	<i>cope</i>	100
43		<i>Makine kapese te medha, per 240 flete</i>	<i>cope</i>	50
44		<i>DVD+R 16X 4.7GB, pako me 10cp</i>	<i>pako</i>	20
45		<i>Evidenciator</i>	<i>cope</i>	100
46		<i>Tastier + Mous bluetooth kit</i>	<i>SET</i>	10
47		<i>Grirese letre</i>	<i>cope</i>	10
48		<i>Pinca rrjeti cilesore</i>	<i>cope</i>	6
49		<i>Universal Cutter Stripper for Flat or Round UTP Cat5 Cat6</i>	<i>cope</i>	6
50		<i>Koka kabull interneti platike</i>	<i>cope</i>	300
51	PO	<i>Libreze uji</i>	<i>cope</i>	100,000
52		<i>SSD i jashtem 1TB</i>	<i>cope</i>	20
53		<i>Set skrivanie lekure ose druri, me minimumi 9 pjese te ndryshme (tapet tavoline, orë, mbajtese per letra A4, per fletepalosje, per letra shenimesh, per stilolapsa, per kapese aktesh, stilolaps, etj). Te gjitha pjeset te jene me material dhe dizeno te njejte.</i>	<i>cope</i>	20
54		<i>Tapet mouse (Mousepad) qe pershtatet me formen e kycit te dores.</i>	<i>cope</i>	40
55		<i>Makina lidhese me spirale teli, hapi 2:1. Hap min. 25fl njeheresh, lidh min.280 flete.</i>	<i>cope</i>	5
56		<i>Tabele e bardhe magnetike e emaluar, me permasa minimumi 90cm X 120cm.</i>	<i>Cope</i>	4
57		<i>Poëer bank</i>	<i>Cope</i>	15
58		<i>Kabull USB-C to USB-A</i>	<i>Cope</i>	40
59		<i>USB type A Charger Block 20Ë 3.0 Compact Fast Charger</i>	<i>Cope</i>	40
60		<i>Mbjtese dokumentash metalike me 4 sirtare, me celes.</i>	<i>Cope</i>	40
61		<i>Kosh letrash metalike</i>	<i>Cope</i>	40
62		<i>Njesi shperndarese e rrymes zgjatues prize me min 8porta dalese AC, min 2 porta USB</i>	<i>Cope</i>	20
63		<i>Cante laptopi shpine 15.6-17" e zeze</i>	<i>Cope</i>	4
64		<i>Kabull vga/vga</i>	<i>Cope</i>	20
65		<i>Kabull DVI/VGA</i>	<i>Cope</i>	10

Specifikimet e letrës:

1	<i>Pesha per letren A4 te bardhe</i>	<i>Sipas pershkrimit</i>
---	--------------------------------------	--------------------------

		<i>perkates ne tabele.</i>
2	<i>Lagështia</i>	3-4.5 %
3	<i>Trashësia</i>	103-112 μ m
4	<i>Drita</i>	\geq 93%
5	<i>Shkëlqimi</i>	101-115 %
6	<i>CIE Bardhësia</i>	jo me e vogel se 148%
7	<i>Ashpersia (aftësia) në përkulje MD : \geq 100 mNm</i>	
8	<i>Ashpersia (aftësia) në përkulje CD : \geq 35 mNm</i>	
9	<i>Përmasat e letrës A4 210*297 mm</i>	
10	<i>Letra A4 të mos shkaktojë bllokimin e makinës fotokopjuese/printerin</i>	
11	<i>Të qëndrojnë e rrafshët pas kopjimit/printimit</i>	
12	<i>Të mos lëshojë pluhur letre në makinën fotokopjuese/printer</i>	
13	<i>Të jetë e lëmuar dhe e rëndë</i>	
14	<i>E përshtatëshme për printim në të dy anët</i>	
15	<i>Të përballojë shpejtësinë e printimit jo më pak se 120-130 faqe në minutë</i>	
16	<i>Nuk pranohet leter e ricikluar.</i>	
17	<i>Të plotësojë standartet ISO 9706 ose ekuivalente, standart që plotëson kushtet për letrat që mbahen për një kohë shumë të gjatë në arkiva</i>	

1	<i>Pesha per letren A3 te bardhe</i>	<i>Sipas pershkrimit perkates ne tabele.</i>
2	<i>Lagështia</i>	3-5 %
3	<i>Trashësia</i>	103-112 μ m
4	<i>Drita</i>	\geq 93%
5	<i>Shkëlqimi</i>	101-115 %
6	<i>CIE Bardhësia</i>	jo me e vogel se 148%
7	<i>Përmasat e letrës A3 420*297 mm.</i>	
8	<i>Letra A3 të mos shkaktojë bllokimin e makinës fotokopjuese/printerin</i>	
9	<i>Të qëndrojnë e rrafshët pas kopjimit/printimit</i>	
10	<i>Të mos lëshojë pluhur letre në makinën fotokopjuese/printer</i>	
11	<i>Të jetë e lëmuar dhe e rëndë</i>	
12	<i>E përshtatëshme për printim në të dy anët</i>	
13	<i>Të plotësojë standartet ISO 9706 ose ekuivalente, standart që plotëson kushtet për letrat që mbahen për një kohë shumë të gjatë në arkiva</i>	
14	<i>Ashpersia (aftësia) në përkulje MD : \geq 100 mNm</i>	
15	<i>Ashpersia (aftësia) në përkulje CD : \geq 35 mNm</i>	
16	<i>Nuk pranohet leter e ricikluar.</i>	

Specifikimet e tonerave:

- Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës
- Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimit të mallit.
- Tonerat të jenë të shoqeruara me pulle sigurie nga prodhuesi ose ekuivalente të tyre dhe me part number-at e kerkuara nga AK. Emri i prodhuesit të jetë i stampuar në kutinë e bojës (dhe jo me etikete), në pullën e sigurisë dhe në kartrixhe, dhe të jetë i njëjti emër prodhuesi në paketimin e bojës, në pullën e sigurisë dhe në kartrixhe.

- Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës.
- Bojrat duhet të jenë origjinale ose ekuivalente, të pershtatura për llojet e printerave, të mos jenë të rimbushura (Recondition); të mos jenë të ricikluara (Remanufactured); të mos jenë të riprodhuara; të jenë të paketuara e të pahapura.

Specifikimet e Grireses së letres:

- Niveli i Sigurisë: min P-4
- DimENSIONI i prerjes së letres: prerje terthore (Cross Cut) 4x40mm
- Sasi e letres së prere njekohesisht: 25-30 fije
- Volumi i koshit: min 210 litra
- Te Grije gjithashtu: kredit karta, kapese, tela, CD
- Te jete me vajosje automatike (Auto oiler)
- DimENSIONI: Gjatesi x gjerësi x thellesi (H x E x D): 900mm-980mm x 600mm-660mm x 500mm-600 mm

Specifikimet e Tabeles së bardhe magnetike e emaluar (Nr.56):

- Tabele e bardhe magnetike e emaluar, me permassa minimumi 90cm X 120cm
- Te shkruhet në të dyja anet me marker dhe të fshihet, me rrotullim 360° dhe me sistem kyçjeje të pjesës magnetike.
- Te kete të inkorporuar mbajtëse për aksesore.
- Te jete me rrota rrotulluese që mbyllën (fiksohen).

Specifikimet e Poëer bank (nr.37):

Kapaciteti: min.30000 mah me 65W USB-C Charger 3.0

Te kete: min.2 porta të dyfishta USB-C

Te kete: min.2 portat e dyfishta USB-A

Afati i lëvrimit të materialeve objekt prokurimi të jetë jo më vonë se 30 ditë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës

III.1.4. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën pikës 2.4.1 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të shtojcës 7 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuar, operatori ekonomik ofertues “INTERLOGISTIC” ShPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

Dokumentin e emërtuar “19_skede_teknike_double_1” e cila është skeda teknike e produktit letër të markës “xxxxxx” të përkthyer dhe të noterizuar.

Në këtë dokument pasqyrohen këto specifikime teknike si më poshtë:

xxxxxx

FLETA E TË DHËNAVE TEKNIKE

Double A 80 - Certifikuar FSC®

SPECIFIKIMET E PRODUKTIT

Veçorite	Metoda	Values
Pesha baze (g/m)	ISO 536	80±3
Kaliper (um)	ISO 534	110±3
Bardhesia CIN	ISO 11475	163±4

Ndriçimi D65 (%)	ISO 2470-2	110±4
Opaciteti (%)	ISO 2471	> 96
Lageshtia (%)	ISO 287	≤ 4
Vrazhdesia e Bendtsen (ml/min)	ISO 8791-2	130\$50
Rezistenca ne perthyerje MD (mN).		>110
Rezistenca ne perthyerje CD (mN)	ISO 2493	>50

Kushtet e testimit: Lageshtia perkatese 50%, Temp. 23° C sipas ISO 187

Referenca: SP-MK-4SO date 11/04/2022

CERTIFIKATAT

Ky produkt este prodhuar nga Double A (1991) PLC.

E cila eshte certifikuar me certifikatat e meposhtme:

150 9001:2015 (Sistemet e menaxhimit te cilesise)

- ISO 14001:2015 (Sistemet e menaxhimit te mjedisit)
- ISO 45001:2018 (Sistemet e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune)
- ISO 9706:2002 (Leter per dokumente - Kerkesat per gendrueshmeri)

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ofertuesi “INTERLOGISTIC” ShPK ka dorëzuar mostrat për artikujt objekt-prokurimi me numër rendor **1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 16, 21, 22, 24, 26, 28, 51** të përcaktuara në Shtojcën 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumentave të tenderit të modifikuara

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur me shkresën nr. 480/8 prot., datë 25.04.2024 me objekt “*Kërkesë për informacion*”, ka kërkuar nga operatorit ekonomik “*INTERLOGISTIC*” ShPK të dorëzojë pranë institucionit tonë informacionin dhe faktet se cili/at nga specifikimet teknike të mësipërme të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumentave të tenderit të modifikuara janë pasqyruar në skedën teknike të produktit të ofruar nga ana juaj të markës “xxxxx” dhe i paraqitur nga ana e tij në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), duke identifikuar secilin prej specifikimeve teknike të kësaj shtojce në skedën teknike të dorëzuar.

III.1.6. Me shkresën e datës 30.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 480/9 prot, datë 02.05.2024, është depozituar nga e operatorit ekonomik “*INTERLOGISTIC*” ShPK përgjigja lidhur me shkresën nr. 480/8 prot., datë 25.04.2024 me objekt “*Kërkesë për informacion*”, ku janë identifikuar në skedën teknike të dorëzuar nga ky ofertues specifikimet teknike të produktit objekt-prokurimi “*Leter A4 e bardhe 80gr/m2*” të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumentave të tenderit të modifikuara, si dhe për specifikimet teknike më numër rendor 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumentave të tenderit të modifikuara është shprehur si në vijim: “*Gjithashtu ju bëjmë me dije se në lidhje me parametrat e kërkuar nga pika 10 deri tek pika 16 janë parametra të p-ërgjithshme të cilët nuk përfshihen në skedën teknike.*”, si më poshtë vijon:

1	Pesha per letren A4 te bardhe	Sipas pershkrimit perkates ne table.	Skede teknike xxxxx
---	-------------------------------	--------------------------------------	---------------------

2	Lageshtia	3-4.5 %	≤ 4%
3	Trashesia	103-112 μm	110+-3 μm
4	Drita	> 93%	> 96%
5	Shkëlqimi	101-115 %	110+-4 %
6	CIE Bardhësia	jo me e vogel se 148%	163+-4
7	Ashpersia (aftesia) ne perkulje MD : ≥ 100 mNm		> 110 mN
8	Ashpersia (aftesia) ne perkulje CD : ≥ 35 mNm		> 50 mN
9	Permasat e letres A4 210*297 mm		A 4, 80 gr/m ² , 210*297 mm
10	Letra A4 te mos shkaktoje blokimin e makinesfotokopjuese/printerin		
11	Te gendroje e rrafshet pas kopjimit/printimit		
12	Te mos leshoje pluhur letre ne makinën fotokopjuese/printer		
13	Te jete e lemuar dhe e rënde		
14	E pershtateshme per printim ne te dy anët		
15	Te perballoje shpejtesine e printimit jo me pak se 120-130 fage ne minute		
16	Nuk pranohet leter e ricikluar.		
17	Të plotesoje standartet ISO 9706 ose ekuivalente, standart		ISO 9706:2002

Gjithashtu ju bëjmë me dije se në lidhje me parametrat e kërkuar nga pika 10 deri tek pika 16 janë parametra të p-ërgjithshme të cilët nuk përfshihen në skedën teknike.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje parashikimet e nenit 92 pika 3 dhe nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”:

“[...] 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigojnë pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.[...]

[...]1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi. [...]

III.1.8. Gjithashtu, Komisioni sjell në vëmendje parashikimet e nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikat 2, 3 dhe 4:

“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për

rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;*
- shuma absolute e të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.*

4. Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”

III.1.9. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36

pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.1.11. Nga shqyrtimi i Shtojcës 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të modifikuara, Komisioni konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar lista e artikujve objekt-prokurimi, me gjithsej 65 (gjashtëdhjet e pesë) artikuj ku janë përcaktuar përshkrimi i emërimit të artikujve, njësia dhe sasia e tyre, ndërkohë që më këtë shtojcë janë përcaktuar specifikimet teknike vetëm për 6 (gjashtë) artikuj objekt-prokurimi dhe konkretisht për artikujt me numër rendor nr. 1 “Letër A4 të bardhë”, nr. 2 “Letër A3 të bardhë”, nr. 26 “Toner”, nr. 47 “Gjirëses së letrës”, nr. 56 “Tabelës së bardhë magnetike e emaluar” dhe nr. 57 “Poëer bank”.

Lidhur me pretendimin e ankimesit për shoqërinë “INTERLOGISTIC” ShPK, ku pretendohet se mostrat e dorëzuara prej tij për artikujt objekt-prokurimi me numër rendor nr. 1 “Leter A4 e bardhe 80gr/m2”, nr. 5 “Dosje A4 plastike, me llastik dhe klip (kapesë)”, nr. 7 “Dosje me unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza. Ne brendesi dosja te permbaje xhep per leter A4 dhe bllok A4, mbajtjese stilolapsi dhe minimumi 3 xhepa te vegjel”, nr. 9 “Dosje me buton, plastike ose ekuivalent rezistente ndaj lageshtires, me gjeresi min 20 cm, me doreze dhe me xhep per etikete shenimesh” dhe nr. 11 “Rapidograf, me majë të hollë 0.3-0.4mm, ngjyre blu. Të mos zbehet dhe të mos lëshojë njolla” nuk plotësojnë specifikimet teknike, Komisioni konstaton se në Shtojcën 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë përcaktuar specifikimet teknike për këta artikujt objekt-prokurimi me numër rendor nr. 5, nr. 7, nr. 9 dhe nr. 11, por vetëm për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 1.

Gjithashtu Komisioni konstaton se për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 1 janë përcaktuar specifikimet teknike si në vijim: “Pesha per letren A4 te bardhe”, “Lageshtia”, “Trashesia”, “Drita”, “Shkëlqimi CIE”, “Bardhësia”, “Ashpersia (aftesia) ne perkulje MD”, “Ashpersia (aftesia) ne perkulje CD”, “Permasat e letres”, “Letra A4 te mos shkaktoje blokimin e makinesfotokopjuese/printerin”, “Te qendroje e rrafshet pas kopjimit/printimit”, “Te mos leshoje pluhur letre ne makinën fotokopjuese/printer”, “Te jete e lemuar dhe e rënde”, “E pershtateshme per printim ne te dy anët”, “Te perballoje shpejtesine

e printimit jo me pak se 120-130 faqe ne minute”, “Nuk pranohet leter e ricikluar” dhe “Të plotesoje standartet ISO 9706 ose ekuivalente, standart”.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vecantë të vendosur.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk i ka hartuar dokumentat e tenderit në përputhje me nenin 36 të ligjit për prokurimin publik, pasi Shtojcës 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të modifikuara është përcaktuar lista e artikujve objekt-prokurimi, me gjithsej 65 (gjashtëdhjet e pesë) artikuj ku janë përcaktuar përshkrimi i emërimit të artikujve, njësia dhe sasia e tyre, ndërkohë që më këtë shtojcë janë përcaktuar specifikimet teknike vetëm për 6 (gjashtë) artikuj objekt-prokurimi dhe konkretisht për artikujt me numër rendor nr. 1 “Letër A4 të bardhë”, nr. 2 “Letër A3 të bardhë”, nr. 26 “Toner”, nr. 47 “Grirëses së letrës”, nr. 56 “Tabelës së bardhë magnetike e emaluar” dhe nr. 57 “Poëer bank”.

Për më tepër, Komisioni gjykon se për artikullin me numër rendor nr. 1 “Letër A4 të bardhë” autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike, por disa përcaktime si: “Letra A4 te mos shkaktoje blokimin e makinesfotokopjuese/printerin”, “Te qendroje e rrafshet pas kopjimit/printimit”, “Te mos leshoje pluhur letrë ne makinën fotokopjuese/printer”, “Te jete e lemuar dhe e rënde”, “E pershtateshme per printim ne te dy anët”, “Te perballoje shpejtesine e printimit jo me pak se 120-130 faqe ne minute”, “Nuk pranohet leter e ricikluar”, nuk mund të konsiderohen si specifikime teknike, pasi në vetvete këto përcaktime nuk shprehin karakteristikat teknike të produktit, por janë terma reference që tregojnë se si ndërvepron artikulli me makinën fotokopjuese dhe ku këto parametra varen nga karakteristikat dhe gjendja funksionale e makinës fotokopjuses dhe për më tepër nuk përcaktojnë specifikimet teknike të letrës në terma funksionalë.

Gjithashtu nisur nga konstatimet e mësipërme, Komisioni gjykon se është në pamundësi që të gjykojë pretendimet e ankimuesit lidhur me specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga ana e shoqërisë “INTERLOGISTIC” ShPK, pasi nga ana e autoritetit kontraktor specifikimet teknike nuk janë hartuar në përputhje me përcaktimet e nenit 36 të ligjit nr. 162 “Për prokurimin publik”, si dhe për disa nga artikujt për të cilët janë paraqitur mostra nuk janë përcaktuar specifikimet teknike në Shtojcës 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të modifikuara, duke mos repektuar përcaktimet e nenit 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162 “Për prokurimin publik”, ku qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentat e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se specifikimet teknike nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

III.1.13. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, sipas të cilit: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të*

drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mospërputhja e krijuar midis kërkesave të parashikuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike dhe shtojcës 2 “Lista e cimeve të artikujve” si dhe shtojcës 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, pjesë e dokumentave të tenderit, ndikon drejtpërdrejtë në hartimin e ofertës ekonomike të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe në vlerësimin e ofertave nga ana e KVO-së si dhe është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” ShPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “INTERLOGISTIC” ShPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që procedura e prokurimit objekt ankese do të anulohet, pretendimet e tjera të palës ankimuese, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “INTERLOGISTIC” ShPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që procedura e prokurimit objekt ankese do të anulohet, pretendimet e tjera të palës ankimuese, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra*”, me Nr. REF-92436-12-28-2023, me objekt: “*Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme*”, me fond limit 7.999.967,23 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SH.A.
 2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “INTERLOGISTIC” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra*”, me Nr. REF-92436-12-28-2023, me objekt: “*Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme*”, me fond limit 7.999.967,23 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SH.A.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” ShPK.
 6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” ShPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

